



VENDIM
Nr. 80 Datë 03.10.2010

PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“FERAR ENERGY” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a” dhe 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03.10.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “FERAR ENERGY“ sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, te kesaj shoqërie,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “FERAR ENERGY“ sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi i Komisionerëve



Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “FERAR ENERGY“ sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “BENCA” dhe Hec “TEPELENA”.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA